

20030721559

**L I G J I**  
**PËR GARANCINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR MARRËVESHJEN**  
**FINANCIARE PËR HUA TË LIDHUR NDËRMJET BANKËS EVROPIANE PËR**  
**INVESTIME DHE SH.A. ELEKTROEKONOMIA E MAQEDONISË PËR REALIZIMIN**  
**E PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E TRAFOSTACIONEVE NË**  
**REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve sipas Marrëveshjes financiare për hua për realizimin e Projektit për ndërtimin e trafostacioneve në Republikën e Maqedonisë që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Investime dhe Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë në një shumë prej 13 milionë euro.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë nga neni 1 i këtij Ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen financiare për hua ndërmjet Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë dhe Bankës Evropiane për Investime dhe Marrëveshjes për dëshmipërblimin dhe garancinë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës Evropiane për Investime, për financimin e Projektit për ndërtimin e trafostacioneve në Republikën e Maqedonisë.

Neni 3

Të gjitha obligimet financiare që dalin nga Marrëveshja financiare për hua nga neni 1 i këtij Ligji, si edhe servisimin e huasë do t'i përmbushë Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë nga të hyrat që i realizon në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen financiare për hua.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij Ligji, do të paguhet në mënyrën si vijon:

Afati i pagesës është 20 vjet me grejs periudhë të inkuadruar prej 5 vjetësh.

Shkalla kamatore që do të përlllogaritet veç e veç për çdo transhë të tërhequr, do të verifikohet nga Banka Evropiane për Investime në ditën e tërheqjes së transhës nga huaja dhe mund të jetë:

- shkallë fikse kamatore, ose
- shkallë e ndryshueshme kamatore e pozicionuar në EURIBOR+0,40%

Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë do të vendosë se cila shkallë kamatore do të zbatohet mbi secilën nga transhat nga huaja, në përputhje me opcionet e ofruara në paragrafin 3 të këtij neni.

Huaja do të paguhet në këste të njëjta gjysmëvjetore konform planeve të pagimit. Për secilën transhë nga huaja do të përpilohet plan i veçantë për pagim, konform kushteve dhe afateve të dhëna në këtë nen dhe do të bëhen pjesë përbërëse të Marrëveshjes financiare për hua.

Neni 5

Nëse obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e caktuara me Marrëveshjen financiare për hua në emër të Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë, i paguan Republika e Maqedonisë, Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë detyrohet brenda 30 ditësh, nga dita e realizimit të obligimit, në dobi të llogarisë së të hyrave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të transferojë mjete në denarë në lartësi të pagimit të realizuar, të rritur sipas kamatës të përlllogaritur dhe sipas shpenzimeve të krijuara në lidhje me transaksionin përkatës.

Ministri i Financave mund t'i lëshojë urdhër Drejtorisë të të Hyrave Publike, për bllokimin e mjeteve të Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë në bazë të kthimit të TVSH-së me qëllim që të përmbushen obligimet e arritura ndaj kreditorit, gjegjësisht shtetit t'i kompenzohen mjete në denarë në lartësinë e pagimit të realizuar, të rritur sipas kamatës së përlllogaritur dhe sipas shpenzimeve të krijuara në lidhje me transaksionin përkatës.

#### Neni 6

Ministria e Financave dhe Sh.A. Elektroekonomia e Maqedonisë do të lidhin marrëveshje, me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella mbi bazë të garancisë së lëshuar ndaj Bankës Evropiane për Investime.

#### Neni 7

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".